



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 364/6 prot.

Tiranë, më 22.5.2025

V E N D I M

Nr.24, datë 22.5.2025

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË, SË
VEPRIMEVE ADMINISTRATIVE TË KRYERA GJATË PROCESIT TË ECURISË
DISIPLINORE, NË INSTITUCIONIN E AGJENCISË PËR ZHVILLIMIN
BUJQËSOR DHE RURAL, NË VARËSI TË MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë zhvillimit të ecures disiplinore ndaj nëpunëses Anida Pashollari, në institucionin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural,

VËREJ SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është regjistruar informacioni i dërguar me shkresat nr. 364 prot., datë 22.3.2025 dhe nr. 364/2 prot., datë 20.3.2025, nga nëpunësja Anida Pashollari, me detyrë “Drejtore në Drejtorinë e Financës”, në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), institucion në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në të cilin ngrihen pretendimet për parregullsi të kryera gjatë zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil, gjatë procedurës së dhënies së masës disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë deri në 3 muaj”, në ngarkim të saj.

Konkretisht, në përmbajtje të informacionit dhe të dokumentacionit të administruar bashkëlidhur tij, parashtrohet se, nëpunësja Anida Pashollari, është emëruar me aktin

nr.9100 prot., datë 31.12.2018, të DAP, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Kontabilitetit”, në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural.

Më tej, pas procedurës së konkurrimit për ngritje në detyrë, me aktin nr. 6648 prot., datë 7.12.2022, të DAP, nëpunësja është emëruar në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Financës”, në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural.

Rezulton se, në zbatim të vendimit të Zv/Ministrit të Financave, është zhvilluar një inspektim mbi zbatimin e ligjshmërisë lidhur me përdorimin e fondeve publike nga ana e institucionit të AZHBR-së në kuadër të instrumentit të BE-së, zbatimit të projektit IPARD II 2014-2020. Mbështetur në konstatimet e nxjerra në Raportin e Inspektimit, në përfundim të këtij procesi, me kërkesën e eprorit direkt, është kërkuar nisja e ecurisë disiplinore për nëpunësen A. Pashollari, për shkak të parregullsive të konstatuara në kryerjen e detyrave të caktuara në këtë projekt.

Duke qenë se, shkelja e konstatuar është klasifikuar si shkelje me pasoja të rënda, çështja i ka kaluar për kompetencë Komisionit Disiplinor. Në përfundim të procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të provave të mbledhura për shkeljen disiplinore të pretenduar, Komisioni i Disiplinës ka vlerësuar se, shkeljet e kryera nga nëpunësja klasifikohen si “*shkelje të rënda*” të disiplinës në shërbimin civil, e për këtë arsye është vendosur dhënia e masës disiplinore “*Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë deri në 3 muaj*”, në ngarkim të saj.

Në lidhje me sa më sipër, nëpunësja ngre pretendimin për parregullsi në lidhje me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, përsa i takon respektimit të procedurës disiplinore.

Në këto kushte, nëpunësja ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e organeve të disiplinës, gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me informacionin e dërguar nga nëpunësja, në mbështetje të kompetencave ligjore të sanksionuara në ligjin nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ka filluar procesin e verifikimit të tij, nëpërmjet shkresës nr. 364/1 prot., datë 19.3.2025, duke vënë në dijeni institucionin për fillimin e verifikimit të kësaj procedure disiplinore, si dhe duke i kërkuar dokumentacionin në të cilën është materializuar ajo.

Në përgjigje të kësaj kërke, institucioni i AZHBR-së, nëpërmjet shkresës nr. 364/3 prot., datë 27.3.2025 “*Shkresë përcjellëse*”, ka dërguar dokumentacionin në të cilin materializohet procedura disiplinore e ndjekur në këtë rast.

Nga përmbajtja e dokumentacionit të administruar rezulton se, në periudhën kohore që nëpunësja Anida Pashollari ka qenë e emëruar në pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Kontabilitetit”, në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, me urdhrin nr.223, datë 22.7.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të AZHBR-së, është ngarkuar për kryerjen e detyrës

shtesë si “Përgjegjëse në Sektorin e Autorizimit të Pagesave, IPARD”, në këtë institucion (revokuar me aktin nr. 228, datë 23.5.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm).

Më pas, me aktin nr. 204, datë 11.5.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm “Për kryerje detyrash shtesë”, kjo nëpunëse është ngarkuar të kryejë përkohësisht detyrën e “Drejtorit në Drejtorinë e Autorizimit të Pagesave”, nga data 11.5.2022 deri më 13.5.2022.

Konstatohet se, në zbatim të vendimit nr. 106, datë 5.12.2023 “Për fillimin e inspektimit financiar publik”, të Zv/Ministrit Financave është zhvilluar një inspektim mbi zbatimin e ligjshmërisë lidhur me përdorimin e fondeve publike nga ana e institucionit të AZHBR-së në kuadër të instrumentit të BE-së, zbatimit të projektit IPARD II 2014-2020.

Në përfundim të këtij procesi inspektimi, është hartuar Raporti dhe urdhri nr. 67, datë 21.5.2024, i Ministrit të Financave, “Për përfundimin e inspektimit financiar publik”, ku në dispozitiv të këtij akti është kërkuar: Titullari i institucionit të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, të fillojë procedurën për dhënien e masës disiplinore, sipas shkallës së përgjegjësisë, për shkeljet dhe parregullsitë e konstatuara në raportin e inspektimit, për dy punonjëse, ndër të cilat A.Pashollari, me detyrë “Përgjegjës/SAPI”.

Në zbatim të këtij urdhri, Drejtori i Përgjithshëm i AZHBR-së, në cilësinë e titullarit të institucionit, e njëkohësisht të eprorit direkt të nëpunëses, ka marrë në shqyrtim gjetjet e Raportit të Inspektimit Financiar Publik dhe me shkresën e datës 1.7.2024 “Njoftim lidhur me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 67, datë 21.5.2024 “Për përfundimin e Inspektimit Financiar””, ka vlerësuar se, shkeljet e konstatuara nga grupi i inspektimit, nuk klasifikohen në kategorinë e shkeljeve të parashikuara në nenin 57, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Më tej, referuar përmbajtjes së Memos me nr. 1456/3 prot., datë 20.9.2024, të Drejtorisë Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse, janë rivlerësuar edhe një herë rrethanat dhe gjetjet e grupit të inspektimit, duke arritur në konkluzionin se, ato përbëjnë shkelje disiplinore me pasoja të rënda, të parashikuara në pikën 3, të nenit 57, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Në këto rrethana, me shkresën nr. 1456/9 prot., datë 20.9.2024, eprori direkt, znj. A. Kuçi, ka kërkuar fillimin e ecurisë disiplinore në ngarkim të nëpunëses dhe kalimin e çështjes për kompetencë Komisionit Disiplinor, të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural.

Komisioni i Disiplinës, i ngritur me urdhrin nr. 594, datë 22.10.2024, të titullarit “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor”, është ndryshuar me Urdhrin nr. 622, datë 04.11.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm, për zëvendësim të kryetarit të Komisionit Disiplinor (për shkak konstatimi të konfliktit të interesit në këtë rast, u bë zëvendësimi i përfaqësuesit të Ministrisë së BZHR me një tjetër nëpunës civil nga ajo ministri) dhe njëherësh është ndryshuar edhe data e mbledhjes së KD.

Pas kësaj, Komisioni i Disiplinës, me shkresën nr. 1456/19 prot., datë 4.11.2024 “*Njoftim fillim ecurie disiplinore*”, ka vënë në dijeni nëpunësen e proceduar për sa më sipër, duke i bërë të ditur të drejtën e saj për të paraqitur sqarimet rreth shkeljeve të pretenduara, të drejtën për t’u dëgjuar vetë ose me përfaqësues, si dhe datën e shqyrtimit në seancë dëgjimore.

Më tej, përbërja e Komisionit Disiplinor është ndryshuar sërish me Urdhrin nr. 84, datë 6.2.2025 dhe me Urdhrin nr. 91, datë 13.2.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm.

Në vijim, Komisioni Disiplinor është mbledhur për të shqyrtuar dokumentacionin e administruar mbi parregullsitë e konstatuara në raportin e inspektimit të MF (*procesverbal nr. 15 prot., datë 6.1.2025*) ku është çmuar e nevojshme zgjatja e afatit të përfundimit të procedurës disiplinore, me qëllim hetimin sa më të plotë të rastit dhe garantimin e të drejtës së nëpunësit për t’u njohur me dokumentacionin. Për këtë arsye, Komisioni Disiplinor me Vendimin e Ndërmjetëm nr. 1, datë 6.1.2025, ka vendosur zgjatjen e afatit për përfundimin e çështjes, duke argumentuar në këtë mënyrë edhe shkakun e tejkalimit të afatit normal të shqyrtimit të çështjeve administrative (*njoftuar nëpunëses në procedim me shkresën nr.15/2 prot., datë 13.1.2025*).

Më pas, siç rezulton nga përmbajtja e procesverbalit nr. 3880 prot., datë 11.11.2024, të Komisionit Disiplinor, të dyja palët janë dëgjuar dhe kanë paraqitur me shkrim pretendimet e tyre mbi shkeljet e pretenduara.

Në përfundim të procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të provave të mbledhura për shkeljen disiplinore të pretenduar, Komisioni i Disiplinës ka çmuar se, shkeljet e kryera nga nëpunësja përbëjnë “*shkelje të rëndë*” të disiplinës, prandaj bazuar në pikën 3, germa a) dhe ç), të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, me vendimin nr. 4, datë 21.2.2025, të Komisionit të Disiplinës është vendosur dhënia e masës disiplinore “*Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë deri në 3 (tre) muaj*”, në ngarkim të nëpunëses Anida Pashollari.

Në vijim të procesit të verifikimit, ka rezultuar se, bazuar në të drejtën që i jep nëpunësit civil, neni 41, pika 3, e ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, nëpunësja në fjalë, nëpërmjet shkresës nr.364/4 prot., datë 25.4.2025 “*Informacion në lidhje me kërkesën e paraqitur pranë KMSHC*”, ka informuar Komisionerin se, me të njëjtin objekt: kundërshtimin e masës disiplinore të dhënë nga Komisioni i Disiplinës, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, proces i cili është në vazhdim.

Për sa më sipër, në bazë të përcaktimit në nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 “*Kodi i Procedurës Civile*” i ndryshuar, në përmbajtje të së cilit sanksionohet se, asnjë institucion tjetër shtetëror nuk mund të trajtojë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, vlerësojmë se, Komisioneri nuk mund të vijojë më tej, procedurën e hetimit të këtij rasti, pasi kjo mosmarrëveshje është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor, në përfundim të së cilit do të japet zgjidhje përfundimtare pas trajtimit në themel të rastit.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; të nenit 90, pika 2, të ligjit nr.44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar; të nenit 36, të ligjit nr. 8116, dt. 29.3.1996 *“Kodi i Procedurës Civile”*, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, e Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ dhe arkivimin e çështjes së filluar kryesisht në mbështetje të informacionit të përcjellë me shkresat nr. 364 prot., datë 22.3.2025 dhe nr. 364/2 prot., datë 20.3.2025, të dërguara nga nëpunësja Anida Pashollari, pasi mosmarrëveshja është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe do të zgjidhet në themel nga gjykata kompetente.
2. Të njoftohet për këtë vendim Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, si dhe nëpunësja Anida Pashollari.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha